



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



BULETINI DITOR I FSSHM-së

PËRMBLEDHJE INFORMACIONESH NGA LËMIA E SHËNDETËSISË TË MARRA NGA SHTYPI DITOR DHE MEDIUMET ELEKTRONIKE

23 Dhjetor 2015



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



ZHURNAL [®]
Agjenci e Lajmeve

Skandal, sirupi për temperature Eferalgan I dëmshëm për fëmijët



Shkup, 22 dhjetor – Një pjesë e serisë së sirupave për temperaturë tek fëmijët Eferalgan nga 90ml me 30mg/ml është larguar nga barnatoret për shitje në Serbi.

"Amikus ka larguar nga shitja sirupat nga shitja me kërkesë të prodhuesit pasi që është zbuluar sajesa në ambalazhë me cka nuk mund të vërtetohet që prodhimi a është kontaminuar", kanë deklaruar nga sektori për regjistrim të barnave në Amikus.

Theksohet se nuk janë vërejtur reaksione tek fëmijët po sirupi është larguar nga shitja për shkaqe sigurie. Prindërve që kanë kështu sirupi nëpër shtëpi ju preferohet që t'i largojnë ato dhe mos t'i përdorin, njofton bebac.com, transmeton Zhurnal.

ALSAT 

Todorov i shpëtoi interpelancës



OJQ-të ndjehen të zhgënjyera nga bashkë-partiakët e ministrit të shëndetësisë Todorov të cilët i dhanë mbështetje politikës shëndetësore të ministrit. Reagimi vjen pasi Todorov i shpëtoi interpelancës pas plotë 12 orë debat në kuvend.

www.fzo.org.mk



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks: 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



“Unë në përgjigje të interpelancës së Todorovit pashë se u krenua me shumë projekte që janë zbatuar, për të cilët mori duartrokitje në fund nga bashkëpartiakët e tij, por si do ta shpjegojë ai faktin se gjithnjë e më shumë njerëz vdesin për shkak të një shërbimi shëndetësor joadekuat, për shkak të përkujdesit të papërshtatshëm”, u shpreh Urania Pirovska, Komiteti Helsinkit.

Nga OJQ-ja Civil thonë se interpelanca ishte një shans për ta shëruar shëndetësinë, sepse ata besojnë se është e sëmurë rëndë.

“Do ishte e ndershme dhe me virtyt vet të tërhiqet, të pendohej për gjithçka që ka ndodhur, të kërkojë falje familjeve që kanë humbur fëmijët dhe anëtarët e familjes dhe ndoshta do ti gjenin një pozitë të re në parti ku do të kishte një kolltuk”, tha Sinisha Stankoviq.

Nga 85 vota, 56 deputetë ishin kundër shkarkimit të Todorovit, ndërsa 29 deputetë të opozitës ishin për. Derisa mbrëmë mbahej seanca, para Kuvendit protestuan qindra qytetarë të cilët kërkuan dorëheqjen e ministrit të shëndetësisë Todorov.



Ndotja e ajrit në nivel të lartë, mjegulla shkakton vështirësi në komunikacion



Manastiri, Tetova, Shkupi dhe Kërçova vazhdojnë të jenë qytete më të ndotura në vend...

Stacionet matëse gjatë 24 orëve të fundit kanë treguar se është tejkaluar kufiri i lejuar i mikrogromëve dhe kanë regjistruar mbi 180 mikrogram në metër kub në këto qytete.

Më pas rangohet edhe qyteti i Kvardarit dhe Koçanit si vende të ndotura. Në orën 9 të mëngjesit, grimcat PM në Manastir kanë shënuar 397 mikrogram, në Tetovë 297, në Kërçovë 183, në lagjen Gazi Babë të Shkupit 323 mikrogram, në Lisiçe 219, në Qendër 285 dhe në Karposh

85 mikrogram në kub.



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks: 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Për shkak të mjegullës në mëngjes, një pjesë e madhe e fluturimeve dhe aterimeve në aeroportin "Aleksandri i Madh" në Shkup u anuluan dhe disa aeroplan janë drejtuar drejt aeroportit të Ohrit dhe Prishtinës, ndërsa gjatë kësaj nate akoma nuk ka paralajmërime për anulime të reja të aterimeve dhe fluturimeve nga ky aeroport.

Ndërkohë mjegulla vështirësoi edhe komunikacionin rrugor, në veçanti në viset malore të vendit. Zvogëlim i shikueshmërisë në komunikacion prej 50 metra është paraqitur në Gostivar, Strumicë, Kriva Pallankë, si dhe në Strazhë. Kujdes të veçantë duhet pasur në akset rrugore: Katllanovë, Veles, Dibër, Strugë, Mavrovë, Demir Kapi dhe Udovë.

Nga Auto-Moto e Maqedonisë u rekomandojnë drejtuesve të automjeteve të respektojnë sinjalizimin rrugor dhe të adaptojnë shpejtësinë e tyre në varësi të kushteve rrugore.

Sinoptikanët paralajmërojnë për sonte dhe ditën e nesërme mjegull pothuajse në të gjithë Maqedoninë.

"Eko-Shtëpiza e parë e gjelbër" nga shishe të ricikluara plastike në Kërçovë



Me më shumë se 1.500 shishe plastike të ricikluara, vullnetarë nga Kërçova ndërtuan Eko-shtëpizë të gjelbër...

Shtëpiza ka natyrë të ricikluar dhe në të ardhmen do të përdoret për kultivimin e luleve dhe fidaneve me çka do të rritet ndërgjegjësimi ekologjik dhe i mjedisit në komunën e Kërçovës.

Në kuadër të aksionit vullnetar përmes të cilës është ndërtuar Eko-shtëpiza e gjelbër ku morën pjesë 40 vullnetarë nga organizatat joqeveritare të të rinjve dhe nga Njësia e Vëzhguesve "Mirko

Mileski", ku edhe gjendet Eko-shtëpiza e gjelbër.

Iniciativën e zbatoi Qendra për hulumtim dhe zhvillim e shoqërisë "Vizio", në bashkëpunim me Forumin rinor arsimor, dhe është në kuadër të Projektit të USAID-it për shoqëri civile.

Aksioni është nxitur me vetëiniciativë nga një grup vullnetarësh të rinj të cilët në qytetin e tyre dëshirojnë të nxisin ide të reja se si ta rrisin ndërgjegjësimin e opinionit për përdorimin praktik dhe kreativ të hapësirave publike në bashkësi, dhe në këtë mënyrë të sigurojë vend që do të ndihmojë në gjelbërimin e komunës. (mia.mk)



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks: 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Aksion humanitar i Kryqit të Kuq të Kumanovës



Vullnetarë të organizatës kumanovare të Kryqit të Kuq përgatisin dekorime të Vitit të Ri, të cilat prej sot do të fillojnë t'ua shesin qytetarëve në vendet e frekuentuara në Kumanovë në shesh, në tregjet e gjelbëra, objektet tregtare, supermarketet...

Dekorimet e përgatitura me dorë do të shiten me çmim simbolik, ndërsa mjetet e mbledhura nga aktiviteti

humanitar para festave do t'u ndahen kategorive të ndjeshme të qytetarëve.

"Ky është aktivitet tradicional, i cili ka për qëllim ta nxitë humanizmin dhe solidaritetin", deklaroi Iva Mlladenovska, bashkëpunëtore profesionale në Kryqin e Kuq të Kumanovës. (mia.mk)

PORTALB
dritare realiteti

Maqedoni, këto janë vendet me temperatura më të ulta, nën zero



Temperaturë më të ulët prej -5 gradë Celsius mëngjesin e sotëm është matur në Berovë, ndërsa pasojnë Dibra, Shtipi dhe Tetova me -4, Mavrova, Shkupi, Strumica dhe Manastiri me -3, Kavadari me -2, Kumanova, Demir Kapia dhe Prilepi me -1. Zero gradë Celsius janë matur në Llazaropole, Kriva Pallankë, Pretor dhe Ohër, 3 në Krushevë dhe Gjevgjeli dhe 4 gradë në Dojran.

Maqedoni, administratorët nuk avancohen nëpër ministri edhe përskaaj përvojës



Punësimi dhe gradimi i të punësuarve në administratë në bazë të aftësive, respektivisht në bazë të meritave dhe jo në bazë të lidhjeve partiake ka të bëjë me atë që në shkenca politike njihet si "merit-sistem", apo sistem i vlerave dhe meritave.



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Sa në administratën e Maqedonisë vlen “merit-sistemi”?! Është pyetje që na imponohet sa herë që publikohet Raport Progresi për Maqedoninë, por edhe ankesat e shpeshta në adresë të redaksisë tonë në lidhje me mosavancimin e drejtë nëpër vende pune.

“Ka një numër të madh të administratorëve që edhe përkaj përvojës së madhe nëpër ministri nuk janë avancuar, që nga pranimit i tyre me shkollë të mesme dhe me përvojë prej 10 viteve edhe përkaj diplomimit të tyre nuk u pranohet e drejta të punojnë në vende adekuate sipas shkollimit, ka të shumtë që punojnë me shumë se 5 vite të diplomuar e disa deri në 9 vite me diploma, që punojnë si referenta (me shkollë të mesme)”, thuhet në letrën e një administratorit dërguar në adresën e redaksisë tonë, i cili insiston të mbetet anonim, shkak i presioneve eventuale partiake.

Se gjatë punësimeve dhe avancimeve nuk merren parasysh meritat vërtetohet edhe Raport Progresi i fundit për vendin. Mirëpo, rekomandimet e KE-së në Raport hasin në vend të shurdhër.

Se roli i administratës është madhor dhe shumë i rëndësishëm vërtetohet edhe doktoranti i Administratës Publike, Argëtim Saliu. Sipas tij, administrata paraqet “motorin” lëvizës të proceseve shtetërore.

Prandaj, nisur nga fakti se kontakti i qytetarëve në raport me administratën është i ditëpërditshëm dhe i pashmangshëm, imponohet nevoja për administratë profesionale sipas sistemit të meritokracisë.

“Në botë ka dy principe apo kritere të punësimit dhe avancimit, ato janë: kriteret e meritokracisë që dominon në vendet e zhvilluara të BE-së dhe “sistemi spoils” ku dominojnë kriteret politiko-partiake, e që janë te pranishme në vendet në zhvillim e sipër. Të gjitha raportet e progresit të Komisionit Evropian dhe Bankës Botërore dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar, dëshmojnë dhe vërtetojnë faktin se Maqedonia ka administratë jo-profesionale. Kjo për shkak të mosrespektimit të principit të meritokracisë”, tha për Portalb Saliu.

Saliu zgjidhjen e sheh tek implementimi i ligjit për nëpunës administrativ.

“Nëse kërkohet zgjidhja atëherë vetëm duhet të implementohet ligji për nëpunës administrativ për arsye se në Maqedoni procedurat e punësimit dhe avancimit në organet e administratës, janë vetëm farsë sa për t’ju përmbajtur procedurës nga aspekti formal, por jo edhe në aspektin material apo përmbajtësorë”, theksoi ai.

Nga Ministria e Ekonomisë na thonë se punësimet dhe avancimet bëhen në mënyrë të rregullt dhe sipas ligjit.

“Në Ministrinë e Ekonomisë dy vitet e fundit ka pasur 25 punësime, prej të cilave afër 10 avancime. Në bazë të ndryshimit në status brenda kohës të punësuarit që kanë diplomuar ose kanë kryer master janë avancuar, siç parasheh ligji. Ka raste që kanë qenë bashkëpunëtorë, tani janë shefa njësisish, këshilltarë, shefa sektorësh. Të gjithë në një kohë nuk mund të avancohen, ne çdo vjet fusim avancime”, tha Naim Vranezi zëdhënës i Ministrisë së ekonomisë, pa precizuar se vallë avancimet dhe punësimet bëhen në bazë të merit sistemit.



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Edhe nga Ministria për Vetëqeverisje Lokale nuk kanë precizuar në përgjigjen e tyre, konkretisht, se me çfarë kriteri avancohen nëpunësit, por vetëm se ka avancime.

“Në ministrinë tonë në masë të madhe respektohet merit sistemi, ku sipas sistematizimit të ministrisë për vetëqeverisje lokale kemi këshilltarë shtetëror, udhëheqës sektori, ndihmës sektori, udhëheqës njësie si dhe këshilltarë. Sa i përket të punësuarve me shkolla të mesme, të cilët kanë kryer fakultet, avancimi i tyre është në procedurë e sipër, pritët pëlqim nga ministria e financave”, shprehen nga sektori për marrëdhënie me publikun.

Ndryshe, nga zyra e Avokatit të Popullit thonë se në zyrat e tyre nuk ka pasur ankesa në lidhje më çështjen që po e trajtojmë ne, për faktin se në Maqedoni nuk ekziston “merit sistemi”.

“Në Maqedoni nuk ka merit sistem, për këtë fakt nuk ka ndodhur që te ne të dërgohen ankesa të këtij lloji”, është përgjigjur shkurt për Portalb Marija Lazarova, zëdhënëse e Avokatit të popullit./Portalb